

URA ME TRI HARQE- Ismail Kadare

Harta e romanit

Autori: Ismail Kadare

Titulli: Ura me tri harqe

Konteksti: Dukuria që e shqetëson autorin është përhapja e islamizmit në botën perëndimore dhe pushtimi i Evropës nga osmanët duke përdorur si urë lidhëse Arbërinë. Ngjarjet zhvillohen në kohën kur Perandoria Osmane fillon të fuqizohet së tepërmi dhe të shtrijë ndikimin e saj në Ballkan.

Tema kryesore: Qëndresa si dukuri abstrakte dhe qëndresa fizike e urës, si edhe kronikat e shkruara në legjendën shqiptare të murimit.

Konflikti kryesor: Përplasja mes aziatikëve dhe evropianëve, islamikëve dhe të krishterëve

Koha reale: Shek. XIV

Koha letrare: 23 Dhjetor, ora 4 pasdite

Personazhet: Murgu Gjon Ukcama, Konti Stres i Gjikëve, Gjeloshi, Murrash Zenebishta etj.

Hyrja: Prezantohet vendi dhe koha e incidentit.

Çasti kulmor: Vrasja e kalorësit turk.

Zgjidhja: Të gjithë përgatiten për luftën e madhe që i pret.

Mesazhi kryesor: Kadareja e sjell simbolin e urës si një parandjenjë, si një ogur, një kërcënim mbi të cilin një komb (kulturë) do të pushtojë një tjetër, e ardhmja do të pushtojë të shkuarën. Kjo prozë e errët, ashtu si dhe vetë historia, vjen si një makth që tregon misterin e lidhur me mjegullën e kohërave të shkuara dhe frymën e legjendës si dhe ankthin, që lidhet me gjendjen psikologjike të personazheve.

* Kjo hartë është bërë kryesisht për fragmentin, që gjendet në tekstin shkollor “Gjuha shqipe dhe letërsia 10” të shtëpisë botuese **Albas**